



Datë: 13.05.2026

A.nr.409/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Argjenda Sherifi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.409/2026, të datës 08.04.2026, të parashtruar nga ankuesit B.Ç, D.K, Y.C, V.Z, V.K, T.I, M.Q, V.B, H.N, Y.D, D.E, B.B, S.B, E.M, S.T, Sh.Ç, Z.A, L.K, N.M, E.Gj, A.Gj, R.R, H.M dhe A.S, të cilët me autorizim i përfaqëson zyra e avokatisë *Klinaku & Associates L.L.C* me seli në Prishtinë, kundër organit të punësimit: Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 13.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.409/2026, e datës 08.04.2026, e parashtruar nga ankuesit B.Ç, D.K, Y.C, V.Z, V.K, T.I, M.Q, V.B, H.N, D.E, B.B, S.B, E.M, S.T, E.Gj, R.R, dhe A.S.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.409/2026, të datës 08.04.2026, të parashtruar nga ankuesit Y.D, Sh.Ç, Z.A, L.K, N.M, A.Gj dhe H.M.

III. Ankuesit si në pikën **II** udhëzohen mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesit (*tutje referuar vetëm ankuesit*), më datë 08.04.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Përgjigjes së datës 05.03.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik dhe në vazhdimësi në 0.5%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.04.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 20.04.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto

prova: Ankesën me numër protokolli 1699/2026 të datës 08.04.2026, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 08.04.2026; Përgjigjen në kërkesë e datës 05.03.2026 të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së; Kërkesën e datës 30.01.2026 të ankuesve e parashtruar tek Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së; Akt Emërimet e ankuesve; Kopjen e ID-së së ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.04.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 20.04.2026.

I. Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, **është e pabazuar**, sepse:

Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesit si në pikën I, janë të punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, dhe se të njëjtit kanë statusin e nëpunsit civil. Rrjedhimisht, Ankuesja B.Ç sipas Akt emërimit me Nr. 800/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Sekretari/ja Juridik/e*, D.K sipas Akt emërimit me Nr. 2049/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Sekretari/ja Juridik/e*, Y.C sipas Akt emërimit me Nr. 1789/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Arkiv*, V.Z sipas Akt emërimit me Nr. 1795/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar Ligjor*, V.K sipas Akt emërimit me Nr. 1808/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Referent i Regjistrimit*, T.I sipas Akt emërimit me Nr. 1790/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar Ligjor*, M.Q sipas Akt emërimit me Nr. 1812/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Referent i Regjistrimit*, V.B sipas Akt emërimit me Nr. 2094/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Referent i Pranimi/Regjistrimit*, ankuesi H.N sipas Akt emërimit me Nr. 1805/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Distribimin e Dokumenteve*, D.E sipas Akt emërimit me Nr. 1802/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Recepçionist*, B.B sipas Akt emërimit me Nr. 1807/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Arkiv*, S.B sipas Akt emërimit me Nr. 1822/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Sekretari/ja Juridik/e*, E.M sipas Akt emërimit me Nr. 1826/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Sekretari/ja Juridik/e*, S.T sipas Akt emërimit me Nr. 2051/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Arkiv*, N.M sipas Akt emërimit me Nr. 243/2013 të datës 05.03.2013, mbanë pozitën *Sekretare Juridike*, E.Gj sipas Akt emërimit me Nr. 1810/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për Arkiv*, R.R sipas Akt emërimit me Nr. 1836/2026 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën *Zyrtar Ligjor*, dhe A.S sipas Akt emërimit me Nr. 2139/2025 të datës 01.09.2025, mbanë pozitën *Administrator*.

-Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre, më datë 30.01.2026, i janë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me kërkesës për kompensimin e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5% nga hyja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

- Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 05.03.2026, iu është përgjigjur ankuesve me duke e refuzuar të njëjtën.

Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se punëdhënësi nuk ka përmbushur obligimin ligjor, sepse dispozitat e nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë nuk kanë qenë në përputhje me Kushtetutën, andaj edhe mohimi i të drejtës për kompensimin e vlerës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë është mohim i të drejtës së fituar, sepse kjo e drejtë është njohur me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kërkojnë që ankesa të aprovet, të njihet e datës e përvojës së punës më 0/5% dhe të kompensohet në mënyrë retroaktive sipas vlerës së dëmit për përvojën e punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publik.

Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike,

nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimin ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur më pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik, dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimit (pra nga data 01.02.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesit kanë qenë të punësuar në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës por që marrëdhënia e tyre e punës ka përfunduar për shkak arritjes së moshës së pensionit, gjegjësisht, Y.D sipas Akt emërimit me Nr. 244/2013 të datës 05.03.2013, ka ushtruar pozitën *Referent*, ndërsa më Vendimin numër 394/2023 të datës 18.09.2023 i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 03.10.2023, Sh.Ç sipas Akt emërimit me Nr. 235/2013 të datës 05.03.2013, ka ushtruar pozitën *Sekretare Juridike*, ndërsa më Vendimin numër 250/2024 të datës 29.05.2024 i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 01.07.2024, Z.A, sipas Akt emërimit me Nr. 253/2013 të datës 05.03.2013, ka ushtruar pozitën *Sekretare Juridike*, kurse më Vendimin me numër 376/2024 të datës 15.08.2024, i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 19.09.2024, L.K sipas Akt emërimit me Nr. 232/2013 të datës 05.03.2013, ka ushtruar pozitën *Referente*, ndërsa më Vendimin numër 137/2024 të datës 19.03.2024 i është

përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 18.04.2024, N.M sipas Akt emërimit me Nr. 243/2013 të datës 05.03.2013, ka ushtruar pozitën *Sekretare Juridike*, ndërsa më Vendimin numër 309/2025 të datës 28.05.2025 i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 27.06.2025, A.Gj sipas Akt emërimit me Nr. 269/2013 të datës 01.07.2013, mban pozitën *Roje Sigurimi*, ndërsa më Vendimin numër 464/2025 të datës 22.08.2025 i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 25.09.2025, H.M sipas Akt emërimit me Nr. 257/2013 të datës 05.03.2013, mban pozitën *Shtëpiak*, ndërsa më Vendimin numër 285/2023 të datës 27.06.2023 i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me efekt prej datës 26.07.2023.

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi si në këtë pikë të arsyetimit kanë humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet se Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë se ankuesit më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk kanë statusin e nëpunësit aktiv civil, rrjedhë se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve të parashtruar më datë 08.07.2026.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji lidhur më të drejtën e ankueseve në mjete juridike udhëzon të njëjtit që të drejtën e tyre materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.409/2026

Argjenda SHERIFI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësueses së ankuesve Klinaku & Associates L.L.C;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore në SKPK; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*